

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje reagentë, qelqurina dhe materiale të tjera për Laboratorin e Kontrollit Marrëveshje Kuadër 24 muaj” për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj, Procedurë e Hapur e Thjeshtuar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me 1(një) operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Reagentë për laborator

33696500-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **6,014,800 (gjashtë milion e katërbëdhjetë mijë e tetëqind) Lekë pa TVSH ose 7,217,760 (shtatë milion e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) Lekë me TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Tiranë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8:

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, dhe në nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” **ose/dhe ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” për artikujt objekt prokurimi (*bazuar në klasifikimin e pajisjes*), të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në pikën 1 të nenit 79 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter gjen mbështetje dhe në pikën 1 të nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit Nr.prot.3330, datë 20.03.2018 dhe Nr.Prot.145, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale të vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, ku përcaktohet se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...], sikurse dhe në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:*

Pika 1: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*

Pika 2/c: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: **40 % të vlerës** së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara se zoterojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në pikën 1 dhe në pikën 2 të nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, është parashikuar marzhi maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, ku përcaktohet shprehimisht se: Pika 2/c: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: **40 % të vlerës** së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence;”- .*

Bazuar në vlerën e fondit limit të përlogaritur për këtë prokurimi që është nën kufirin e ulët monetar (bazuar në nenin 11, pika 1, gërma b) të RPP-së) ky kriter u vendos në përputhje të plotë me marzhin maksimal të përcaktuar për këtë lloj procedure prokurimi (nën kufirin e ulët monetar për mallra) në rregullat e prokurimit publik.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM 285/2021 “Mbi Rregullat e Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;”-*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

2.3 Kapaciteti teknik:

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate**.
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**
 - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", ku përcaktohet se: "*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës..*;", si dhe me pikën 4/b të nenit 55 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: *[...] b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.."*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor për aftësinë të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë **jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.**

- a) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **autorizim nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi**, për tregtimin e mallrave objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, origjinal ose fotokopje e noterizuar.

Shënim: Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, ai garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (*ref. Vendimit të KPP nr. 353/2014*).

Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit Nr.Prot. 3341/1, datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore “*Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik*”.

- b) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) kimist/ biolog/ bioteknolog/ inxhinier (ose fusha të ngjashme) në stafin e vet, të vërtetuara me diplomë dhe kontratë individuale pune të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor për aftësinë teknike dhe profesionale të stafit teknik të OE ofertues, i cili do të angazhohet në procesin e marrjes së porosisë dhe ekzekutimin me profesionalitet të kontratës (ekspert i fushës).

- c) Për të gjithë artikujt e ofruar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (*Specifikimet teknike*), **të paraqitet Katalogje, ku të përfshihen specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull** (*pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen*). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (**të markuara sipas artikullit**) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 dhe 77 të të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën 5. Objekti i prokurimit është specifik, dhe impakti që ka finalizimi me sukses i kësaj kontrate është garantimi i cilësisë dhe sigurisë së barnave që vendosen në treg kundrejt kryerjes së analizës së barit.

ç) Operatori ekonomik duhet të paraqese **oferten teknike**, për artikujt e kërkuar në formë tabele, ku të plotësohen: **Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit**, Emërtimi i katalogut të artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet përkatëse për produktet (*bazuar në klasifikimin e mallit (pajisjes).*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur me qëllim që të identifikohet përmbushja e specifikimeve teknike për artikujt e kërkuar si dhe është në përputhje me pikën 1 të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se: *1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ky kriter është në përputhje me pikën 2 të nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “ 2.Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Në këtë kontekst ligjor është kërkuar dhe oferta teknike, me qëllim verifikimin me saktësi dhe lehtësisht të artikujve të ofertuar, specifikimeve teknike të tyre, origjina, konformiteti, etj. me dokumentacionin ligjor, teknik dhe profesional të paraqitur nga ofertuesi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

Nr.	Emërtimi	Specifikime	Njësia
Laboratori Fiziko – Kimik			
1	Acetonitril	Acetonitril për HPLC. Formula kimike CH_3CN . Masa molare 41.05 g/mol , Pastertia (GC) $\geq 99.9\%$.	Fl x 2,5 L
2	Methanol	Metanol për HPLC: Formula kimike CH_3OH Masa molare 32.04 g/mol Pastertia $\geq 99.8\%$, Densiteti 0.792 g / cm ³	Fl x 2,5 L
3	Acid sulfanilik	Acid sulfanilik Formula kimike : $\text{C}_6\text{H}_7\text{NO}_3\text{S}$ Masa Molare : 173.19 g/mol Tretshmëria në ujë : 12.51 g/L	Fl x 100 g
4	Phosphate Sodium (Trisodium Phosphate anhydrous)	Phosphate Sodium (Trisodium Phosphate anhydrous) Formula kimike : Na_3PO_4 Masa Molare : 163.939 g/mol Pika e shkrirjes : 1,583 °C (2,881 °F; 1,856 K) (anhydrous)	Fl x 25 g
5	Permanganat Kaliumi	Permanganat Kaliumi Formula kimike : KMnO_4 Masa Molare : 158.03 g/mol	Fl x 100 g
6	Methyl Ethyl Keton	Methyl Ethyl Keton (2-Butanone) Formula kimike : $\text{C}_4\text{H}_8\text{O}$ Masa Molare : 72.11 g/mol	Fl x 1 L
7	Acetat ammoniumi	Acetat ammoniumi Formula kimike : $\text{C}_2\text{H}_7\text{NO}_2$ Masa Molare : 77.083 g/mol Pika e shkrirjes : 113 °C (235 °F;386 K) Densiteti :1.17 g/cm ³ (20 °C)	Fl x 500gr
8	Sodium acetat	Sodium acetat Formula kimike: CH_3COONa , Masa molare: 82.03 g/mol, Densiteti: 1.528 g/cm ³ , CAS number: 127-09-3.	Fl x 250 g
9	Sodium Benzoate	Sodium Benzoate Formula kimike: $\text{C}_7\text{H}_5\text{NaO}_2$; Masa molare 144,11 g/mol; Densiteti: 1,497 g/cm ³ ; CAS number: 532-32-1	Fl x 250 g
10	Sodium deoxycholate	Sodium deoxycholate Formula kimike: $\text{C}_{24}\text{H}_{39}\text{NaO}_4$ Masa molare : 414.56 g mol	Fl x 25 g

		CAS number:302-95-4	
11	Fixanal HNO ₃ 0.1N	Fixanal HNO₃ 0.1N Solucion i perqendruar per 1L, ampule per pergatitjen per solucione Formula kimike: HNO ₃ ; volumetrike. CAS number: 7697-37-2	Fl x 100 ml
12	Fixanal HNO ₃ 1N	Fixanal HNO₃ 1N Solucion i perqendruar per 1L, ampule per pergatitjen per solucione volumetrike Formula kimike: HNO ₃ ; CAS number : 7697-37-2	Fl x 100 ml
13	Fixanal H ₂ SO ₄ 1N (0.5M)	Fiksanal H₂SO₄ 1N Solucion i perqendruar per 1L CAS Number 7664-93-9;	Fl x 100 ml
14	Acid citrik	Acid citrik Formula kimike: C ₆ H ₈ O ₇ Masa molekulare: 192,124 g/mol Densiteti: 1,66 g/cm ³ CAS number: 77-92-9	Fl x 500 g
15	Decane-1-sulfonic acid sodium salt	Decane-1-sulfonic acid sodium salt Formula kimike: CH ₃ (CH ₂) ₈ CH ₂ SO ₃ Na; Masa molekulare:244,33 g/mol CAS number: 13419-61-9; assay~98%	Fl x 25 g
16	Sodium di Hydrogen Phosphat	Sodium di Hydrogen Phosphat Formula kimike: NaH ₂ PO ₄ ; Masa molekulare: 119.98 g/mol Densiteti: 2.36 g/cm ³ CAS number:7558-80-7	Fl x 500 g
17	Di sodium Hydrogen Phosphat	Di sodium Hydrogen Phosphat Formula kimike: Na ₂ HPO ₄ ; Masa molekulare: 141.96 g/mol Densiteti: 1.7 g/cm ³ CAS number: 7558-79-4	Fl x 500 g
18	Dichlormetan per analize	Dichlormetan Formula kimike: CH ₂ Cl ₂ Masa molekulare: 84.93 g/mol Densiteti: 1.3266 g/cm ³ CAS number: 75-09-2	Fl x 1 l
19	Fixanal Sodium Hydroksid 1 N	Fiksanal Sodium Hydroxide 1 N NaOH Solucion i perqendruar per 1L, CAS number 1310-73-2	Fl x 100 ml
20	Fixanal Sodium Hydroksid 0,1N	Fiksanal Sodium Hydroxide 0.1 N NaOH Solucion i perqendruar per 1L, CAS number 1310-73-2	Fl x 100 ml
21	NaOH (i ngurtë)	Sodium hydroxide Formula kimike: NaOH Masë molare :39.9971g/mol Pika e shkrirjes: 323 °C (613 °F; 596 K) CAS number:1310-73-2	Fl x 500 gr
21	Amonium hydrogen fosfat	Amonium hydrogen fosfat Formula kimike: (NH ₄) ₂ HPO ₄	Fl x 500 g

		Masë molare : 132.06 g/mol CAS number: 7783-28-0	
22	Dikalium hydrogen fosfat	Dikalium hydrogen fosfat Formula kimike: K_2HPO_4 ; Masa molare: 174.20 g/mol; Densiteti: 2.3 g/cm ³ CAS number: 7758-11-4	Fl x 500 g
23	Kalium dyhidrogen fosfat	Kalium dyhidrogen fosfat Formula kimike: KH_2PO_4 ; Masa molare 136.09 g/mol Densiteti: 2,338 g/ml CAS number: 7778-77-0;	Fl x 500 g
24	Triethylamine	Triethylamine Formula kimike $C_6H_{15}N$ Masa molare: 101.193 g/mol Densiteti: 0.7255 g/ml CAS number: 121-44-8	Fl x 1 l
25	Etanol 96 %	Etanol 96 % , Formula kimike CH_3CH_2OH , Masa molare 46.07 g/mol Pasteria $\geq 95 \%$, Densiteti 0.805 g / cm ³	Fl x 2.5L
26	Etanol absolut	Etanol absolut Formula kimike CH_3CH_2OH , Masa molare 46.007 g / mol Densiteti 0. 78945 g / cm ³ · ne (20 ⁰ C)	Fl x 2.5 L
27	n-Heptyl sulfate sodium salt	n-Heptyl sulfate sodium salt Formula kimike: $CH_3(CH_2)_6OSO_3Na$ Masa molare: 218.25 g/mol Pika e shkrirjes: 199 ⁰ C CAS number: 18981-98-1	Fl x 5 g
28	Acetyl acetone	Acetyl acetone Formula kimike: $C_5H_8O_2$ Masa molare: 100.117g/mol Densiteti: 0.975 g/mL CAS number: 123-54-6	Fl x 100 ml
29	Acid acetik	Acid acetik Formula kimike: CH_3COOH Masa molare: 60.05 g/mol P. sasior: 99 % Densiteti: 1.05 g/ cm ³	Fl x 1 L
30	Aceton	Aceton Formula kimike: C_3H_6O Masa molare 58.080 g/mol Densiteti: 0.7845 cm ³ (25 °C)	Fl x 1L
31	Fixanal HCl 0,1 N	Fiksanal Hydrogen Chloride 0.1 N Solucion i përqënduar për 1L Formula kimike: HCl CAS number: 7647-01-0	Fl x 100 ml

32	Fixanal HCl 1 N	Fiksanal Hydrogen Chloride 1 N Solucion i përqënduar për 1L Formula kimike: HCl CAS number: 7647-01-0	Fl x 100 ml
33	Trimethylamine	Trimethylamine Formula kimike: C ₃ H ₉ N Masa molare: 59.112 g·mol Densiteti: 670 kg m ⁻³ (at 0 °C) 627.0 kg m ⁻³ (at 25 °C) CAS number: 75-50-3	Fl x 1 L
34	Ammonium hidroksid	Ammonium hidroksid Formula kimike: NH ₄ OH Masa molare: 35.05 g/mol Densiteti 0.9 g/mL në 25 °C 0.9 g/mL at 25 °C CAS number: 1336-21-6	Fl x 1 L
35	Heptafluorobytiric acid	Heptafluorobytiric acid Formula kimike: C ₄ HF ₇ O ₂ Masa molare: 214.04 Densiteti: 1.645 g/mL at 25 °C CAS number: 375-22-4	Fl x 25 ml
36	Argent nitrate	Argent nitrate Formula kimike: AgNO ₃ Masa molare: 169.87 Densiteti: 4.35 g/cm ³ (24 °C) 3.97 g/cm ³ (210 °C) CAS number: 7761-88-8	Fl x 100 gr
37	Tetrahydrofurane	Tetrahydrofurane Formula kimike: C ₄ H ₈ O Masa molare: 72.107 g/mol Densiteti: 0.8876 g/cm ³ at 20 °C, liquid CAS number: 109-99-9	Fl x 1 L
38	Propanol 2	Propanol 2 Formula kimike: C ₃ H ₈ O; Masa molare: 60.1 g/mol Densiteti: 0.786 g/cm ³ CAS number: 67-63-0	Fl x 1L
39	Acid trifluoroacetik	Acid trifluoroacetik Formula kimike: C ₂ HF ₃ O ₂ Masa molare: 114.023g/mol Densiteti: 1.489 g/cm ³ CAS number: 76-05-1	Fl x100 ml
40	Acid trichlor acetik	Acid trichlor acetik Formula kimike: C ₂ HCl ₃ O ₂ Masa molare: 163.38 g/mol Densiteti: 1.63 g/cm ³ CAS number: 76-03-9	Fl x100 gr
41	Tretesire buferike 4.00	Solution Buffer pH= 4.00 ± 0.02 (20°C)	Fl x 500 ml
42	Tretesire buferike 7.00	Solution Buffer pH=7.00 ± 0.02 (20°C)	Fl x 500 ml
43	Tretesire buferike 10.00	Solution Buffer pH=10.00 ± 0.02 (20°C)	Fl x 500 ml
44	Edetate disodium	Edetate disodium	Fl x 100 g

		Formula kimike: $C_{10}H_{18}N_2Na_2O_{10}$ Masa molare: 372.24 g/mol CAS number: 6381-92-6	
45	Pentane-1-sulfonic acid sodium salt	Pentane-1-sulfonic acid sodium salt Formula kimike: $C_5H_{11}NaO_3S$ Masa molare: 174.20 g/mol P. sasiar: 98% CAS number: 22767-49-3	Fl x 25 g
46	Hexane-1-sulfonic acid sodium salt	Hexane-1-sulfonic acid sodium salt Formula kimike: $C_6H_{13}NaO_3S$ Masa molare: 188.22 g/mol P. sasiar: 98% CAS number: 2832-45-3	Fl x 25g
47	Octyl sulfate sodium salt	Octyl sulfate sodium salt Formula kimike: $CH_3(CH_2)_7OSO_3Na$ Masa molare: 232.27 g/mol CAS number: 142-31-4	Fl x 5 g
Laboratori Mikrobiologjik			
48	Tryptone Soya Agar (Casein soya bean digest agar)	- Pancreatic Digest of Casein 15.0 g - Papaic Digest of Soybean 5.0 g - Sodium Chloride 5.0 g - Agar 15.0 g pH=7.3 ± 0.2	Fl x 500 g
49	Sabouraud dextrose agar	- Dextrose 40.0 g - Mixture of Peptic Digest of Animal Tissue and Pancreatic Digest of Casein (1:1) 10 g - Agar 15.0 g - pH=5.6 ± 0.2 - Të pëmbaj chloramphenicol	Fl x 500 g
50	MacConkey Agar	- Pancreatic digest of gelatin 17.0 g - Peptones (meat and casein) 3.0 g - Lactose Monohydrate 10.0 g - Sodium Chloride 5.0 g - Bile Salts 1.5 g - Agar 13.5 g - Neutral Red 30.0 mg - Crystal Violet 1mg - pH=7.1 ± 0.2	Fl x 500 g
51	Manitol salt Agar	- Pancreatic Digest of Casein 5.0 g - Peptic Digest of Animal Tissue 5.0 g - Beef Extract 1.0 g - D-Mannitol 10.0 g - Sodium Chloride 75.0 g - Agar 15.0 g - Phenol Red 0.025 g - pH=7.4 ± 0.2	Fl x 500 g

52	Cetrimide Agar	<ul style="list-style-type: none"> - Pancreatic Digest of Gelatin 20.0 g - Magnesium Chloride 1.4 g - Dipotassium Sulfate 10.0 g - Cetrimide 0.3 g - Agar 13.6 g - Glycerol 10.0 ml - pH=7.2 ± 0.2 	Fl x 500 g
53	Pepton Water		Fl x 500 g
54	Polyoxyethylene (80) sorbitan monooleate (polysorbate 80)	<p>Formula kimike: C₆₄H₁₂₄O₂₆</p> <p>Masa molare: 1310 g/mol</p> <p>CAS Number: 9005-65-6</p>	Fl x 500 ml
55	Kit per ngjyrimin e gramit	<p>Kiti te permbaje minimumi keto reagente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Solucion Iodin / lugol 2. Solucion Crystal violet / gentian violet 3. Solucion Safranine / carbol fuksine 4. Solucion Dekolorues /alkool / acetone. 	Set me 4 Fl x 50 ml
56	Vaj Cedri	Vaj Cedri për mikroskopin me immersion	Fl x 25 ml
57	Thioglycollate Fluid Medium	Terren i lenget, steril, gati per perdorim per testin e sterilitetit te mbyllur. Sasia e mbushjes se flakonit 100 ml. Te jete me kapak te pershtatshem qe te injektojme shiringen pa e hapur terrenin.	Fl x 100 ml
58	Sabouraud dextrose broth	Terren i lenget, steril, gati per perdorim per testin e sterilitetit te mbyllur. Sasia e mbushjes se flakonit 100 ml. Te jete me kapak te pershtatshem qe te injektojme shiringen pa e hapur terrenin.	Fl x 100 ml
59	Fluid A 300 ml	Rinse fluid A(shpelares) steril, gati per perdorim per testin e sterilitetit te mbyllur. Sasia e mbushjes se flakonit 300 ml. Te jete me kapak te pershtatshem qe te injektojme shiringen pa e hapur kapakun.	Fl x 300 ml
60	Fluid D 300ml	Rinse fluid D(shpelares) steril, gati per perdorim per testin e sterilitetit te mbyllur. Sasia e mbushjes se flakonit 300 ml. Te jete me kapak te pershtatshem qe te injektojme shiringen pa e hapur kapakun.	Fl x 300 ml
61	Sistem per testin e sterilitetit te mbyllur (Sterility test canister)	Sistem per testin e sterilitetit te mbyllur (kanistra te shoqerurara me sistemin e tubave percjelles dhe agen injektuese.) Paketimi te permbaje 2 kanistra. Vellimi i kanistres 100ml- 120 ml. Diametri i filtrit 47mm dhe madhesia e poreve 0.45 µm. 100 sisteme te jene per serume, 30 per antibiotic dhe 70 per ampula.	Sistem
62	Fluid Thioglycolate medium	<ul style="list-style-type: none"> - L-Cystine 0.5 g - Agar 0.75 g - Sodium chloride 2.5 g - Glucose monohydrate/ anhydrous 5.5 g/ 5.0 g - Yeast Extract (water-soluble) 5.0 g - Pancreatic Digest of Casein 15.0 g 	Fl x 500 g

		<ul style="list-style-type: none"> - Sodium Thioglycollate 0.5 g ose Thioglycolic Acid 0.3 ml - Resazurin Sodium Solution (1 in 1000) 1.0 ml - pH=7.1 ± 0.2 	
63	Alkool	Alkool etilik i cnatyruar 70%, antiseptic dhe dezinfektues per perdorim te jashtem.	Fl x 5 L
64	Gel-clot Limulus Amebocyte Lysate (LAL reagent)	Gel-clot Limulus Amebocyte Lysate (LAL), reagent 5 ose 5.2ml (50 teste/vial), sensitiviteti i endotoksines 0,125 UE/ml Per deteksionin e endotoksines sipas metodes Gel-Clot.	Fl x 5 ose 5.2 ml
65	Control Standart Endoksine E-Coli	Control Standart Endoksine E-Coli 500Ng/fl. Per deteksionin e endotoksines sipas metodes Gel-Clot.	Fl x 500 Ng
66	Ujë LAL reagent 50ml/fl	Ujë LAL reagent 50ml/fl	Fl x 50 ml
67	Glass dilution tubes per testin e endotoxins me metoden gel clot	Glass dilution tubes per testin e endotoxinës me metoden gel clot, Endotoxine free, borosilikat tub, me kapak, permasat:16x90mm	copë
68	Glass reaction tubes per testin e endotoksines metoda gel- clot	Glass reaction tubes per testin e endotoksines metoda gel- clot, Endotoxine free, borosilikat tub, me kapak (Screw Cap), permasat:10x75mm	copë
69	Endotoxine free, glass pipet	Endotoxine free, glass pipet 1ml, per testin LAL.	copë
70	Endotoxine free, glass pipet	Endotoxine free, glass pipet 5ml, per testin LAL.	cope
71	Maja pipetash	Sterile, apirogene, 100-1000µl, te paketuara secila cope vecmas.	cope
72	Maja pipetash	Sterile, apirogene, 20-200µl, te paketuara secila cope vecmas.	copë
73	Shtame bakteriale referente te Bacillus subtilis	Bacillus subtilis, (shtame bakteriale referente te standartizuara sipas Klasifikimeve Taxonomike ndërkombetare dhe kërkesave farmakopeale me një nga kodet e meposhtme): ATCC 6633, CIP 52.62, NCIMB 8054, NBRC 3134 Te kene dhe solucionet rihidratuese	copë
74	Shtame bakteriale referente te Staphylococcus aureus	Staphylococcus aureus, (shtame bakteriale referente të standartizuara sipas Klasifikimeve Taxonomike ndërkombetare dhe kërkesave farmakopeale me një nga kodet e meposhtme): ATCC 6538, CIP 4.83, NCTC 10788, NCIMB 9518, NBRC 13276 Te kene dhe solucionet rihidratuese.	copë
75	Shtame bakteriale referente te Candida albicans	Candida albicans, (shtame mykotike referente të standartizuara sipas Klasifikimeve Taxonomike ndërkombetare dhe kërkesave farmakopeale me një nga kodet e mëposhtme): ATCC 10231, IP 48.72, NCPF 3179, NBRC	copë

		1594 Te kene dhe solucionet rihidratuese.	
Qelqurina			
76	Hinke e vogel	Materiali: Borosilikat, me diameter Ø 3.5 cm dhe diameter ne dalje 0.7 cm, kapaciteti 8 ml (± 1 cm)	copë
77	Hinke e vogel	Materiali: Borosilikat, me diameter Ø 5.5 cm dhe diameter ne dalje 0.9 cm, kapaciteti 30 ml (± 1 cm)	copë
78	Hinke e mesme	Materiali: Borosilikat, me diameter Ø 7.5 cm dhe diameter ne dalje 0.9 cm, kapaciteti 60 ml (± 1 cm)	copë
79	Hinke e mesme	Materiali: Borosilikat, me diameter Ø 9.5 cm dhe diameter ne dalje 1 cm, kapaciteti 200 ml (± 1 cm)	copë
80	Havani i mesem	Material porcelani, i pajisur me dorezën përkatëse, Ø 10-12 cm	copë
81	Havani i vogel	Material porcelani, i pajisur me dorezën përkatëse, Ø 7-9 cm	copë
82	Kristalizator qelqi i vogel	Material qelqi i vogel me diameter Ø 8-10 cm	cope
